



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:187692

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05499132

KA.nr.350/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “Nika Pharm” ShPK me NUI 810800559 dhe seli në Veternik pjesa veriore në Prishtinë, të cilin sipas prokurës e përfaqëson avokati B.Q. me seli në rrugën Sali Çeku p.nr. në Ferizaj, kundër të paditurit Ministria e Shëndetësisë, Inspektorati i Shëndetësor, objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 22.03.2024 në të cilën mori pjesë paditësi me përfaqësuesin e tij, ndërsa i padituri mungoi, më 25 mars 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “Nika Pharm” ShPK me NUI 810800559 kundër të paditurit Ministria e Shëndetësisë, Inspektorati i Shëndetësor, me të cilën ka kërkuar anulimin e akti administrativ nr.10/K-104-20 të datës 02.12.2020 të së paditurit dhe shfuqizimin e aktit administrativ nr. 05-5192 të datës 27.09.2019 të Inspektoratit Farmaceutik.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 30.12.2020 e ka iniciuar konfliktin administrativ me kërkesë për anulimin e aktit administrativ nr.10/K-104-20 të datës 02.12.2020 të së Paditurit dhe shfuqizimin e aktit administrativ nr. 05-5192 të datës 27.09.2019 të Inspektoratit Farmaceutik.
2. Paditësi në padi por edhe gjatë seancës së shqyrtimit kryesor ka pretenduar se Inspektorati Farmaceutik e kishte inspektuar barnatoren e tij gjersa farmacisti

përgjegjës kishte dal për të blerë ose ngrënë ushqim, ndërsa barnatoren nuk e kishte mbyllur sepse në lokal gjendej edhe tekniku i farmacisë, rrjedhimisht i ishte shqiptuar gjobë në lartësi prej 1000€. Sipas tij, akti administrativ i goditur është në kundërshtim me nenin 7 para. 7 dhe 12 të Ligjit 02/L038 për Inspektoratin Shëndetësor, pasi Inspektorati Farmaceutik ka mundur t'i shqiptoj vërejtje e jo gjobë, duke e marrë parasysh se gjithçka ka qenë në rregull, përjashtimisht mungesës momentale të farmacistit përgjegjës. Ka shtuar se gjoba është e pa drejtë, meqenëse tekniku i farmacisë nuk ka qenë duke shitur barna gjatë kohës sa nuk ka qenë prezent farmacisti përgjegjës. Gjatë seancës ka deklaruar se ligji nuk e parasheh se në mungesë të farmacistit barnatorja duhet të mbyllet, e aq më tepër kur dihet se si tekniku ashtu edhe farmacisti mund të ketë nevoja për të dal për ndonjë ushqim ose ndonjë gjë tjetër për një afat të shkurtër për 15-20 min.

3. I Padituri me përgjigjen në padi e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e Paditësit dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj atë, ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor nuk mori fare pjesë, ndonëse ishte ftuar me rregull. Ai në përgjigje në padi vetëm e ka përshkruar në mënyrë kronologjike gjendjen faktike të konstatuar nga ai.

II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

4. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e prova, me përjashtim të dëgjimit të pronarit të Paditësit. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: vendimi nr. 10/K-104-20 i datës 02.12.2020 i Inspektoratit Shëndetësor; vendimi nr. 10/B-013-19 i datës 26.09.2019 i Inspektoratit Farmaceutik; ankesa e paditësit e protokolluar në Ministrinë e Shëndetësisë nr. 05-7520 më datë 11.11.2020; procesverbali mbi inspektimin me nr. rendor 00979 të datës 11.09.2019 Inspektoratit Farmaceutik; raporti i inspektimit me nr. prot. 05-5191 i datës 27.09.2019 i Inspektoratit Farmaceutik, si dhe të gjitha shkresat e lëndës të procedurës administrative të cilat i padituri i ka bashkëngjitur në padi.
5. Gjykata e refuzoi dëgjimin e R.B., si aksionar i vetëm i Paditësit, meqenëse, siç rrjedhë nga procesverbali nr. rendor 00979 i datës 11.09.2019 ai nuk kishte qenë prezent në barnatore në ditën kur është bërë inspektimi, rrjedhimisht për këtë gjykatë ai nuk e ka asnjë informacion relevant lidhur me gjendjen faktike.

6. Në bazë këtyre provave gjykata konstaton se Inspektorati i Farmaceutik më 11.09.2019 e kishte inspektuar lokalitetin e të Paditësit në Prishtinë dhe mes tjerash kishte konstatuar që gjatë orarit të punës nuk kishte qenë prezent farmacisti licencuar ose ai zëvendësues, si dhe kishte urdhëruar që barnatorja të mbyllet dhe të mos operoj pa prezencën e farmacistit të licencuar. Këto fakte nuk ishin kontestuese mes palëve, por vërtetohen edhe nga procesverbali mbi inspektimin me numër rendor 00979 i datës 11.09.2019.
7. Gjykata vëren se nuk ishte kontestuese mes palëve se tekniku i farmacisë nuk ishte duke shitur barna gjatë kohës kur nuk ishte prezent farmacisti përgjegjës.
8. Më 06.09.2019 Inspektorati Farmaceutik e kishte nxjerrë aktin administrativ 10/B-013-19 me të cilin e kishte gjobitur me 1000€ të Paditësin për shkak të mungesës së farmacistit përgjegjës ose zëvendësues gjatë orarit të punës. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes aktit administrativ të sapo cekur.
9. Më 11.11.2020 Paditësi kishte ushtruar ankesë ndaj aktit administrativ të cekur në pasuesin e mësipërm, ndërsa Inspektorati Shëndetësor përmes aktit administrativ nr. 10/K-104-20 të datës 02.12.2020 e kishte refuzuar ankesën e Paditësit dhe e kishte vërtetuar aktin administrativ të ankimuar.

III. Vlerësimi meritor i rastit

10. Gjykata pas analizimit të thënave të Paditësit dhe të Paditurit, si dhe provave në shkresat e lëndës në kuptim të nenit 8 të LPK-së erdhi në përfundim se kërkesëpadia e Paditësit është e pabazuar në ligj.
11. Gjendja faktike e përshkruar më lart rregullohet me nenin 14 të Ligjit 04/L-190 për Produktet dhe Pajisjet Medicinale (këtu e tutje LPPM), i cili në para. 2 ka përcaktuar se *“Barnatorja duhet të ketë gjatë gjithë orarit të punës farmacist/farmacistet e licencuar”*. Pra, sipas këtij paragrafi, barnatorja nuk mund të punoj përderisa nuk e ka prezent farmacistin e licencuar.
12. Në anën tjetër, gjobat janë paraparë me nenin 37 të LPPM-së, i cili në para. 1 ka përcaktuar se *“Shkelja e dispozitave të këtij ligji, akteve të tij nën-ligjore dhe kushteve nga autorizimet dhe licencat e lëshuara në pajtim me këtë ligj, do të jenë subjekt i gjobitjes”*, ndërsa në para. 3 ka sanksionuar se *“Inspektorati farmaceutik mund të shqiptoj gjoba në vlerë deri në njëmijë (1.000) euro”*. Siç vërehet, sipas këtyre normave,

çdo shkelje e dispozitave LPPM-së do të gjobitet, ndërsa lartësia e gjobës është deri në 1000€.

13. Në bazë të dispozitave të cituara më lartë dhe gjendjes faktike të konstatuar, gjykata vjen në përfundim se Paditësi e kishte shkelur nenin 14 para. 2 të LPPM-së, rrjedhimisht Inspektorati Farmaceutik me të drejtë i kishte shqiptuar gjobë, ndërsa Inspektorati i Shëndetësisë me të drejtë e kishte refuzuar ankesën e Paditësit.
14. Gjkata e vlerëson si të pabazuar pretendimin e Paditësit se tekniku i farmacisë nuk ka qenë duke shitur barna pa praninë e farmacistit të licencuar, rrjedhimisht nuk ka pasur shkelje. Siç u sqaruar edhe më lartë, nenin 14 para. 2 i LPPM-së kërkon që gjatë gjithë orarit të punës të jetë prezent farmacisti i licencuar, ndërsa këtë obligim nuk e përcakton vetëm për situatat kur në barnatore ka klient që dëshirojnë të blejnë barna. Fakti që barnatorja ka qenë e hapur gjatë orarit të punës nënkupton se ka qenë e gatshme të pranojë klient për shitjen e barnave, rrjedhimisht prania e farmacistit të licencuar ka qenë ligjërisht e obliguar.
15. Gjithashtu, gjykata e gjen të pabazuar pretendimin e Paditësit se ligji nuk e parasheh se barnatorja duhet të mbyllet në rast të mungesës disa minutëshe të farmacistit. Është e vërtetë se LPPM nuk parash se barnatorja duhet të mbyllet nëse nuk është prezent farmacisti i licencuar, megjithatë fakti që ligji e ka paraparë të obligueshme praninë e farmacistit të licencuar nënkupton se a barnatorja nuk mund të ofroj shërbime farmaceutike pa praninë e farmacistit të licencuar. Në këtë drejtim, nuk është e thënë që barnatorja t'i mbyll dyert e saj, por në çdo formë të bëjë me dije për çdo kë të gjatë periudhe kohore kur farmacisti i licencuar nuk është prezent ajo nuk ofron shërbime farmaceutike. Përveç kësaj, udhëzimi administrativ 11/15 për Qarkulluesit me Pakicë për Produktet dhe Pajisjet Medicinale i Ministrisë së Shëndetësisë në nenin 6 para. 4 e ka paraparë mundësinë që barnatorja të ketë farmacist zëvendësues, i cili i mundëson barnatores që të mos mbyllet në rast se farmacisti i licencuar mungon.
16. Edhe pretendimin e Paditësit se Inspektorati Farmaceutik ka mundur të shqiptoj vërejtje e jo gjobë sipas nenit 7 para. 7 dhe 12 të LSh-së. Gjkata sqaron se sipas atyre dispozitave, nuk parashihet shqiptimi i vërejtjeve. Madje, në asnjë dispozitë të LSh-së nuk parashihet shqiptimi i vërejtjes.
17. Në anën tjetër, gjykata gjen se procedura që i ka paraprirë nxjerrjes së aktit administrativ të goditur është zbatuar në tërësi sipas rregullave të procedurës

administrative. Në këtë drejtim, gjykata vëren se nga Paditësi nuk kishte ngritur asnjë pretendim i kësaj natyre gjatë procedurës së konfliktit administrativ.

18. Përveç kësaj, gjykata vëren se i Padituri ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm për të gjitha çështjet relevante të rastit, si dhe për të gjitha pretendimet e Paditësit, që i ka paraqitur gjatë gjithë procedurës administrative. Gjykata vëren se Paditësi nuk kishte paraqitur pretendim lidhur me mungesat eventuale në arsyetimin e vendimit të goditur.
19. Gjykata gjithashtu konstaton se i Padituri e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike, siç është sqaruar edhe në pjesën e gjendjes faktike në këtë arsyetim.

IV. Shpenzimet procedurale

20. Paditësi gjatë seancës së shqyrtimit kryesor ka kërkuar që të detyrohet i Padituri që t'ia shpërblej shpenzimet e procedurës, konkretisht 104€ për padi si dhe 135€ për përfaqësim të seancës. Meqenëse sipas neni 64 të LKA-së secila palë i bartë shpenzimet e vera, atëherë gjykata vendosi si në pikën II. të dispozitivit.
21. Për arsyet e cekura më lartë, gjykata përfundimisht vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, rrjedhimisht duhet të refuzohet. Prandaj duke u bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.350/2022

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimi. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.